Biblioletra

REVISTË E BIBLIOTEKËS KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE TË KOSOVËS

VITI 1 • NUMRI 2 • QERSHOR 2004

Bibliotekat e kompjuterizuara

Gjon BERISHA

Interesimit për libra, revista, harta, etj., të botuara në gjuhë dhe vende të ndryshme të botës, ka shtruar përpara bibliotekave nevojën e automatizimit të informacionit bibliotekar. Zhvillimi i shkencave në përgjithësi, kërkon domosdoshmërisht informatizimin e bibliotekave, i cili do të mundësojë grumbullimin, ruajtjen dhe shpërndarjen me metoda bashkëkohore të informacionit, e kjo më së miri arrihet me sigurimin e programeve kompjuterike bibliotekare. Automatizimi i një biblioteke ka të bëjë me zbatimin e informatikës në proceset dhe shërbimet bibliotekare. Sot në botë ekzistojnë mjaft programe bibliotekare, të cilat zgjedhen dhe përcaktohen nga vetë biblioteka, veçanërisht nga nevojat e saj. Pavarësisht nga emri apo lloji i programeve, e rëndësishme është që ato programe të jenë të ndërtuara mbi bazën e standarteve të shkëmbimit të informacionit. Në disa biblioteka, kompjuterizimi fillon që nga shërbimi i pasurimit të fondeve, kurse, në disa të tjera, me katalogimin elektronik - deri te shërbimi me përdorues. Katalogu i kompjuterizuar në rrjet (online) po bëhet gjithnjë e më shumë forma më e preferuar. Regjistrimet bibliografike të ruajtura në kujtesë të kompjuterit apo në kompakt disk (CD-ROM), shfaqen në ekran varësisht nga kërkesa e përdoruesit. Derisa në katalogun tradicional informacioni për një njësi të dhënë, paraqitet në skedë (letër), në katalogun e kompjuterizuar ky informacion paraqitet sipas një formati standard të njohur me emrin MARK (Machine Readeble Cataloging-Katalogimi i lexueshëm nga Makina), i cili është zhvilluar në forma të ndryshme duke marrë emrin sipas vendeve (UKMARK, Angli), (USMARK, SHBA), (CATMARK, Kataloni - Spanjë) deri te ai UNIMARK Authorities (UNIMARK i termave të unifikuara). Këto dallojnë ndërmjet vete nga vëllimet informative dhe rënditja e fushave.

/ vijon në faqe 6 /



Në këtë numër

Biblio letra
REVISTË E BIBLIOTEKËS KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE TË KOSOVËS
Biblioteka t ekompjuterizuara
Gjon BERISHA

Raporti korrelativ ndërmjet librit, lexuesit dhe bibliotekës 8

Gjendja e fondeve muzikore në BKUK 10

U themelua Konsorciumi i Bibliotekave Elektronike të Kosovës 12

Trajnime në teknologjitë e reja informative 13

Shoqëria dhe të menduarit pasiv për bibliotekat publike 14

Udhëzime për bibliotekarë në negocimin për blerjen e resurseve elektronike 16

FONDACIONI "MIQTË E BIBLIOTEKËS KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE TË KOSOVËS"

Jeronim de Rada

Dielli gnë lind në Perëndim

Qëllimet:
Fondacioni është formuar më 10 maj 2004 dhe përkrah: bashkëpunimin e BKUK-së me institucionet kulturore dhe arsimore brenda dhe jashtë vendit, si dhe bashkëpunimin me partnerë të tjerë; shkëmbimin e kulturave dhe të përvojave në të gjitha sferat kulturore. Mbështet ruajtjen, pasurimin dhe hulumtimin e fondeve të librave dhe fondeve të tjera, që kanë të bëjnë me kulturën; financon blerjet e përzgjedhura; avancon aktivitetet arsimore dhe kulturore, publikimet dhe botimet më jetën kulturore të Universitetit, qytetit dhe vendit.

Bordi:
- Ali Podrimja – **kryetar**
- Ibrahim Berisha – **nënkryetar**
- Lavdrije Domi – **sekretare**
- Hazbije Qerqi – **ndihmësekretare**

Fondet e librave:
Biblioteka Kombëtare në fondin e saj numëron mbi 1.000.000 njësi bibliotekare, koleksione të shtypit periodik e materiale të tjera, të grupuara sipas llojit të materialit a të përmbajtjes.
Me vlera të veçanta është edhe fondi i librave të rrallë dhe i dorëshkrimeve me vlerë, jo vetëm në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhë të huaja.

Bibliotekat legate:
Kontribut mjaft të madh në pasurimin e fondit të librave të BKUK-së kanë dhënë edhe donatorë të librit, të cilët i kanë dhuruar BKUK-së, bibliotekat e tyre shtëpiake. Në të ardhmen, me ndihmën Fondacionit, mendojmë që këto biblioteka t'i vendosim në dhoma të veçanta për personalitetet shqiptare dhe të huaja.

Informatat:
Në qershor të vitit 2003 në internet është aktivizuar faqja e BKUK-së (Web-site) **www.biblioteka-ks.org**, e cila disponon me të gjitha informatat që kanë të bëjnë me BKUK-në si: historiku, koleksionet, aktivitetet kulturore që janë organizuar në BKUK etj. Gjithashtu, Web- site, ofron edhe mundësinë e kontaktit të të gjithë të interesuarve me BKUK-në dhe me Fondacionin "Miqtë e BKUK-së" në adresën: **miqteebibliotekes@biblioteka-ks.org**.

Anëtarësimi:
Shuma vjetore për anëtarësim në këtë Fondacion është:
- 50 Euro për individë
- 500 Euro për shoqata dhe fondacione të ndryshme.
- Për donacione me vlerë më të lartë se 500 Euro, Fondacioni do t'i jep sponzorit mirënjohje dhe ajo do të botohet në revistën e BKUK-së "Biblioletra". Pastaj, do të bëhet edhe ndarja e çmimit "Mik i librit" për donatorë të veçantë.

Privilegjet e anëtarëve të Fondacionit "Miqtë e BKUK-së":
- Pranojnë ftesa për ekspozita, ligjërata, promovime dhe koncerte që organizohen në hapësirat e BKUK-së.
- Ftohen të marrin pjesë në të gjitha solemnitetet e organizuara me rastin e vizitës së personaliteteve të njohura: shkrimtarë, artistë, piktorë dhe figura eminente nga këmi të tjera të kulturës.
- Marrin gratis revistën e BKUK-së "Biblioletra" dhe benificione të tjera.

I. HISTORIKU
- Biblioteka e Kosovës u themelua në dhjetor të vitit 1944, në Prizren.
- Kuvendi i Kosovës në vitin 1974 merr vendim për ndërtimin e objektit të Bibliotekës, i cili është kryer më 1981.
- Objekti i tanishëm ka 16 500 m^2 me dritare zenitale, në formë të kupolave (gjithsej 99). Ka sallën qendrore me 400 ulëse, sallën e periodikut me 54 ulëse, sallat speciale për punëtorë shkencorë me 18 ulëse, lokale administrative, Amfiteatrin e Madh me 150 ulëse, Amfiteatrin e Vogël me 75 ulëse me kabina për përkthim simultan, laboratoriumin e konservimit, fotolaboratoriumin dhe libërlidhtoren.
- Qendra Amerikane
- Dhoma e internetit
- Qendra Informative për Qeverisje Parlamentare
- Arkivi Medial

II. DEPARTAMENTET
- **Departamenti i Përpunimit të Koleksioneve Bibliotekare**
- **Departamenti i Informacioneve dhe i Shërbimeve Bibliotekare**
- **Departamenti i i Koleksioneve të Veçanta**
- **Departamenti i Bibliografisë**
- **Departamenti i Hulumtimit dhe i Zhvillimit të Veprimtarisë Bibliotekare**
- **Departamenti i Burimeve dhe i Shërbimeve Kompjuterike**
- **Departamenti i Administratës**
- **Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë**
- **Zyra e Botimeve**

III. SYNIMET

BKUK-ja e ndihmuar nga FMBKUK angazhohet në:
1. Bashkëpunimin dhe integrimet ndërkulturore;
2. Pasurimin e fondeve të BKUK-së;
3. Krijimin e koleksioneve dokumentare

Fondacioni është asociacion i të gjithë miqve të librit në botë.

BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS
THE NATIONAL AND UNIVERSITY LIBRARY OF KOSOVA
www.biblioteka-ks.org

Botues: BKUK, **Kryeredaktor i botimeve:** Dr. Sali Bashota, **Kryeredaktor:** Vehbi Miftari
Këshilli redaktues: Mr. Shukrie Rama, Bedri Gashi, Fazli Gajraku, **Lektor:** Muhamet Çitaku, **Realizimi kompjuterik:** Hekuran Rexhepi, **Fotoreporter:** Bashkim Binaku
Adresa: Sheshi "Hasan Prishtina", p.n, Prishtinë
Tel: ++381 38 225-605, Fax: ++381 38 248-940
E-mail: biblioletra@biblioteka-ks.org

BKUK-ja zgjodhi ALEPH-in 500

Kompania Ex Libris LTD, më 22 mars të vitit 2004 nënshkri kontratën në Prishtinë, për implementimin e programit ALEPH 500, Sistemit të Integruar Bibliotekar për Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Kontrata u nënshkrua në prani të një numri të madh të mediave elektronike dhe të shkruara. Në mesin e pjesëmarrësve të ceremonisë së nënshkrimit të kontratës ishin Z. Colin Parish, Zëvendës-shef i Zyrës Britaneze në Prishtinë, Z. Michael McClellan- Zyrtar për Marrëdhënie me Publikun- Zyra Amerikane në Prishtinë, dhe më se 100 mysafirë të ftuar, përfshirë përfaqësuesit e shtypit kombëtar, radiostacionet dhe kanalet televizive.

Është kënaqësi e veçantë të nënshkruhet kjo kontratë. Ne presim implementimin e programit ALEPH 500 në Bibliotekën tonë Kombëtare dhe Universitare, tha Dr. Sali Bashota, Drejtor i BKUK. "Programi ALEPH është qartas zgjidhja më e mirë për bibliotekën tonë dhe do të kontribuojë në shumë projekte tona novatore që do t'i ndërmarrim në të ardhmen. Veçanërisht ngashënjyese për ne, është mundësia e bashkëpunimit ndërkombëtar me bibliotekat tjera që zotërojnë ALEPH-in. Kosovarët kanë shpresë të madhe në programin ALEPH dhe në Kompaninë EX-Libris, dhe unë jam sigurt se këta të fundit do të ofrojnë zgjidhje superiore."

Në emër të presidentit të kompanisë Ex-Libris Ltd., Z. Matti Shem Tov, foli Alan Oliver, menagjer i shitjes në këtë kompani. "Meqenëse po nënshkruajmë këtë kontratë sot, ne jemi të kënaqur dhe të nderuar t'i dëshirojmë mirëseardhje Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës në rrjetin e bibliotekave kombëtare që posedojnë programin ALEPH 500, Unë jam i impresionuar me largpamësinë që pati në vendimmarrje BKUK dhe shpresojmë në një partneritet të frytshëm dhe të gjatë"- ishte fjala e presidentit.

Alan Oliver në prezantimin e tij para qindra mysafirëve vendorë dhe ndërkombëtarë vlerësoi se kompania Ex-Libris është udhëheqës botëror në fushën e zgjedhjeve të programeve për biblioteka dhe qendra informative. Më se dy dekada si udhëheqëse në fushën e bibliotekarisë dhe sistemeve informative, Ex-libris vazhdon të ngrisë standardet industriale duke harmonizuar fuqitë softuerike dhe kërkesat bibliotekare që të sigurojë zgjidhje reale në vazhdimësinë e kërkesave zhvillimore për biblioteka dhe qendra informative. Sipas Z. Oliver, viti 2003 ishte viti prijës për implementimin e Ex-Librisit dhe ALEPH 500 në më se 100 vende aktuale. "Edhe viti 2004 duket të jetë i shkëlqyeshëm. Në çerekun e parë të këtij viti tregtimet kanë qenë të sukseshme dhe kontratat e reja veçse po shihen në horizont."

Ex-Libris, përkatësisht ALEPH 500, Sistem i Integruar Bibliotekar është instaluar në më se 800 vende dhe konsorciume të përfshira në 50 shtete. Edhe prodhimet tjera të kësaj kompanie janë po aq të rëndësishme. MetaLib, portë informative për koleksione bibliotekare, dhe SFX, ndërlidhje e ndjeshme për burime elektronike heterogjene, në hapësirat e diturisë informative është adoptuar në më se 540 institucione në 30 vende. Programi DigiTool, për krijimin e koleksioneve digjitale si komponennte e përgjithshme e strategjisë digjitale, qarkullon i pavarur nga produktet e Ex-Libris-it. Varësisht nga kërkesat e kohës, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, në të ardhmen do të hapërojë edhe nëpër produktet tjera të Ex-Libris-it.

SH. RAMA

JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVË

Aktvitete të rëndësishme për librin, bibliotekën dhe kulturën shqiptare

Manifestimi tashmë tradicional Java e Bibliotekës në Kosovë, i cili u organizua për herë të dytë nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Zyra Amerikane në Kosovë, këtë vit u mbajt nga 19 deri më 24 prill. Gjatë Javës së Bibliotekës u zhvilluan aktivitetete të ndryshme, siç është prezentimi i Planit Strategjik për Bibliotekën Kombëtare dhe për Bibliotekën Universitare të Kosovës nga Dr. Keneth Oberembt, nënshkrimi i Aktit të Mirëkuptimit për themelimin e Qendrës Informative të BKUK-së për Qeverisjen Parlamentare dhe Inaugurimi i Konsorciumit të Bibliotekave Elektronike.

Prezentimi i Planit Strategjik për BKUK-në nga Dr.Kenth Oberembt vjen pas një pune të frytshme të tij në konsolidimin e këtij institucioni si drejtor i përkohshëm e mëpastaj si Këshilltar i Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Mr. Rexhep Osmanit për biblioteka. Materiali i prezantuar në këtë strategji është përmbledhje e përvojës së vjelur gjatë qëndrimit të tij në Kosovë. Strategjia... ofron një projekt të rëndësishëm mbi të ardhmen e BKUK-së që koincidon edhe në harmoni me Ligjin e Bibliotekave të aprovuar në Kuvendin e Kosovës, duke dhënë kështu përgjigje konkrete se çka do të ndodhë me të ardhmen e bibliotekës, kur dhe si do të funksionojnë si të ndara Biblioteka Kombëtare dhe Biblioteka Universitare.

Nënshkrimi i Aktit të Mirëkuptimit për Qendrën Informative të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës për Qeverisje Parlamentare, në mes të UNDP-së (Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara), Kuvendit të Kosovës dhe BKUK-së është edhe një hap i rëndësishëm në demokratizimin e jetës në Kosovë, që do t`i mundësojë qytetarit qasjen e lirë e të drejtpërdrejtë në punën e institucioneve kryesore të Kosovës, siç është Kuvendi i Kosovës. Po ashtu, një nga aktivitetet e rëndësishme gjatë kësaj jave ishte edhe akti i inaugurimit të Konsorciumit të Bibliotekave Elektronike (në qendrën e Internetit të BKUK-së), që do t`i mundësojë qasjen në shumë burime elektronike për bibliotekën si dhe udhëzimet për përdorimin e burimeve të EBSCO-së.

Prezentimi i kulturave suedeze, finlandeze e gjermane e begatuan këtë manifestim. BKUK-ja trajtohet si një institucion që përfaqëson Kosovën në aktivitetet ndërkombëtare për librin dhe bibliotekarinë në përgjithësi.

Koloritin e këtij manifestimi e shtuan edhe shumë prezantime e ligjerata kuptimplote me interes shkencor, si: Prezentimi i Vehbi Miftarit, ndimësdrejtor i BKUK-së dhe anëtar i komitetit IFLA/FAIFE, me temën Bibliotekat dhe liria intelektuale. Me vlerë ishin edhe ligjeratat e Ibrahim Gashit, Studimet diplomike dhe posdiplomike në SHBA si dhe ligjerata e Mr. Ibrahim Berishës, Globalja dhe lokalja, e cila u përcoll nga

shumë pjesëmarrës.

Të një rëndësie të veçantë ishin edhe ligjëratat e dy mysafirëve nga SHBA, znj.Sophia K.Jordan, drejtoreshë e Ruajtjes (Preservation) në Bibliotekën Sheridan, Universiteti John Hopkins, me temën Vlerësime për nevojat e restaurimit dhe të konservimit, hapat e parë, dhe znj.Sheron Fawcett nga Biblioteka Presidenciale e SHBA-ve me temën Dokumenmtet presidenciale, menagjimi dhe arkivimi i dokumenteve të një kombi.

Javën e Bibliotekës në Kosovë e relaksuan edhe aktivitetet tjera, siç ishin: shfaqja e filmit dokumentar Shetitje nëpër vargje, Edgar Alan Poe (Qendra Amerikane), shfaqja teatrale ,,Tokë e premtuar" me aktorët Selman Jusufi e Selman Lokaj, ekspozitat e BKUK-së me revistat dhe gazetat e vjetra nga Shqipëria (referuese Fahrije Simnica) dhe librat - dhuratë nga Shqipëria (tituj të zgjedhur) referues Nehat Krasniqi, dita e donacioneve për BKUK-në rezultoi e frytshme me pasurimin e fondeve të bibliotekës, me ç'rast u dhuruan botimet e gazetës "Rilindja", të botuar në Tiranë, nga Skënder Zogaj, kryetar i Kuvendit Komunal të Fushë Kosovës, pastaj doreshkrimet e veprave të Josip Relës nga shkrimtari Ramiz Kelmendi etj.

Me vëmendje të veçantë u ndoq edhe ekspozita personale e piktorit Eshref Çahili, si dhe koncerti i muzikës klasike Fryma e Re në organizim të Erëmira Çitakut. Përurimi i veprave të Atë Anton Arapit dhe mbrëmja poetike me poetin Ali Podrimja përmbyllën me sukses njërin nga manifestimet më të rëndësishme kulturore në Kosovë.

I. ABDYLI

Bibliotekat e kompjuterizuara

/ vijon nga faqja 1 /

Katalogu elektronik ka formën e përafërt të një pyetësori, i cili është i organizuar në blloqe, fusha dhe nënfusha. Qëllimi i formatit MARK është t'i ndajë në pjesë elementet e katalogimit dhe t'i organizojë në mënyrë të tillë që të kuptohen e manipulohen nga kompjuteri. Kjo kërkon që regjistrimet të jenë të standardizuara.
Formati MARK përdor kode numerike e alfabetike për t'i identifikuar elementet e katalogimit, të cilat janë të ndara në fusha dhe nënfusha, të cilat, po ashtu, vendosen në blloqe funksionale. Kështu, blloqet 0-1 përmbajnë të dhëna të koduara, blloqet 2-8 përmbajnë të dhëna bibliografike, kurse blloku 9 është i rezervuar për përdorim kombëtar. Zakonisht fushat janë të ndara me kode numerike të përbëra nga tri shifra të quajtura tiketa të fushave. P.sh. kodi 200 identifikon titullin, 010-ISBN, 210-vendi i botimit, 675-KDU, etj. Kurse nënfushat me shkronja të vogla të alfabetit, ku i paraprin një shenjë e dollarit ($), p.sh. $a. Pas tiketës treshifrore vendoset edhe një indikator ose tregues me dy numra njëshifror, kurse, kur indikatori është i papërcaktuar, vendoset shenja (#),p.sh.680##.
Në këtë format mund të punohen të gjitha llojet e materialeve: monografike, serike, hartografike, jolibra, materiale audio-vizuele, etj.
Meqë Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës nuk ka ende ndonjë program bibliotekar të instaluar, por është në fazën e realizimit të një programi të kompanisë Ex Libris, më poshtë do të paraqesim, në mënyrë të përgjithshme, pa u bazuar hollësisht në ndonjë program të caktuar, se si duket katalogimi elektronik:

Më poshtë po e japim një shembull të regjistrimit tipik në formatin UNIMARK Authorites, përafërsisht në mënyrën e leximit automatik nga komjuteri duke u bazuar në të dhënat e sipërshënuara.

001 2020901141236
010 ##$a9951406092$d 3
101 1#$ashqip
200 1#$aNdriçime të historisë, kulturës dhe të artit shqiptar
210 ##$aPrishtinë$cKuvendi Salezian$d2002
215 ##$a408fq.$d20cm
311 ##$ashënime për autorin fq.403$bfjalë paraprake fq.7-8
606 #1$ashqiptarët-historia
675 ##$a949.65
700 #0$aSirdani, Marin
801 #0aKSbWE/NOA$c9tetor2002$gAAC2
987 00$a6844591SIR
Pasi të jetë kryer puna e katalogimit, të gjitha të dhënat barten dhe hudhen nga mirëmbajtësi i programit në Internet, gjegjësisht në Ueb Faqen e bibliotekës, të cilat, nga ai moment, janë në shërbim të përdoruesit. Nga shpejtësia dhe komoditeti i vënies në dispozicion të përdoruesve të të dhënave të katalogut varet edhe vlefshmëria e gjithë sistemit bibliotekar.
Kërkimi në katalogun elektronik. Ndryshe nga skedarët tradicionalë, ku kërkimi bëhet në skedarët e letrës, të vendosur në kutia prej druri apo metali, në katalogun elektronik kërkimi bëhet në kompjuter.
Zakonisht kompjuterët për katalog vendosen në hollin e bibliotekës, kurse numri i tyre varet nga numri i përdoruesve. Mirëpo, kërkimi në katalogun elektronik (online) mund të bëhet edhe nga kompjuteri shtëpiak ose nga një Internet-kafe duke e ditur adresen e Ueb Faqes së bibliotekës. Pra nga shtëpia apo nga një skaj tjetër i botës, mund të informohesh se ku gjendet libri i juaj i preferuar.
Pasi që përdoruesi e hap faqen e kërkimit, në ekran do t'i paraqiten mundësi të ndryshme të informimit mbi veprimtarinë e bibliotekës e me këtë edhe mbi katalogun e bibliotekës. Mundësia e kërkimit në katalogun elektronik është e shumëllojshme dhe mjaft e lehtë për t'u shërbyer. Ajo i ofron mundësi përdoruesit, që materialin e preferuar, ta kërkojë sipas autorit, titullit, subjektit, revistës, ISBN-së, ISSN-së, etj. Pra, mjafton që të dish

vetëm titullin e librit - dhe jo autorin, ose të dish autorin - por jo titullin, dhe kështu mund ta gjesh lehtë. Nëse dëshirojmë të kërkojmë, sipas autorit, atëherë e klikojmë fjalën Autori, me ç'rast, në shiritin e kërkimit e shkruajmë mbiemrin dhe emrin e autorit të ndarë me presje (shih. fig.1).

Kodet e fushave dhe nënfushave	Emrat e fushave dhe nënfushave	Të dhënat
0XX	**Bllloku i identifikimit ndërkombëtar**	
001 $a	përcaktuesi i regjistrimit	20020901141236.
010 ## $a	ISBN-ja	9951406092
$d	Çmimi	5€
1XX	**Bllloku i informacionit të koduar**	
101 1#$a	gjuha e veprës	Shqip
2XX	**Bllloku i informacionit përshkrues(titullit)**	
200 1#	fusha e titullit dhe e personave përgjegjës	
$a	titulli i veprës	Ndrigjime të historisë,të kulturës dhe të artit shqiptar
$b	tipi i materialit	
$d	titulli paralel	
$e	informacioni plotësues	
$f	të dhënat për përgjegjësit	Zgjodhi dhe përgatiti për shtyp Anton Nikë Berisha
205##	fusha e botimit	
$a	të dhënat për botimin (numri i botimit)	
210##	fusha e të dhënave të botimit	
$a	vendi i botimit	Prishtinë
$b	adresa e botuesit	
$c	emri i botuesit	Kuvendi Salezian
$d	data e botimit	2002
215##	fusha e përshkrimit fizik	
$a	baza e faqeve	408
$c	ilustrimet	
$d	Dimenzionet	20cm
$e	materialet shoqëruese(p.sh.CD, hartë, etj)	
225##	fusha e series	
$a	titulli i series	
$d	titulli paralel	
$f	përgjegjësit e se ries	
$x	ISSN-ja e series	
3XX	**Bllloku i shënimeve -vërejtjeve**	
311 ## $a	të dhënat plotësuese	shënime për autorin f.403
4XX	**Bllloku i hyrjeve të lidhura**	
454 #1 $a	Lidhjet	
5XX	**Bllloku i titujve të lidhur**	
500 1#$a	titulli uniform	
6XX	**Bllloku i analizës së subjektit**	
606 #1$a	emërtimet lëndore	Shqiptarët -historia
675 ##$a	Numri i klasifikimit sipas KDU -së	949.65
7XX	**Bllloku i përgjegjësisë intelektuale**	
700 #0$a	Autori kryesor	Sinani,Marin
701 ##$a	autorë të tjerë	
9XX	**Bllloku i përdorimit ndërkombëtar**	
801 #0$a	kodi i vendit	KS
$b	agjencia kataloguese	WE/NOA
$c	data e regjistrimit	9 tetor 2002
$g	kodi i rregullave të katalogimit	AACR2
9XX	**Bllloku i përdorimit kombëtar**	
967 0#$a	Numri i vendit të lënë sipas vendosjes	684691SIR

Si rezultat i parë i këtij kërkimi na paraqitet një tabelë e

veprave të autorit të kërkuar me të dhëna të shkurtëra, ku na jipet emri dhe mbiemri i autorit, titulli i veprës dhe vendi i ndodhjes së veprës. Për të ditur më hollësisht për veprën e zgjedhur, atëherë klikojmë mbi veprën e preferuar dhe na paraqiten të dhëna më të hollësishme, si: emri dhe mbiemri, titulli dhe nëntitulli, vendi i botimit, botuesi, signatura, nr.i faqeve, ISBN-ja, subjekti, etj. Veç këtyre të dhënave, përdoruesi automatikisht, nga kompjuteri, mund të informohet nëse materiali është në huazim apo edhe mbi numrin ekzistues të kopjeve të materialit të kërkuar, mbi kohëzgjatjen e huazimit, etj. Huazimi i materialeve. Pas gjetjes së materialit në katalog, përdoruesi shkon dhe e kërkon vetë materialin në fonde (nëse biblioteka është me fonde të hapura), kurse e plotëson reversin, (nëse biblioteka është me fonde të mbyllura). Për ta kryer këtë lloj huazimi duhet që bilioteka ta ketë sistemin e sigurimit të materialeve bibliotekare. Sigurimi i materialeve bëhet zakonisht me vendosjen e një shiriti alarmues në brendi të materialit ose të një vule alarmuese. Kurse në çdo dalje të objektit të bibliotekës vendosen shtyllat magnetike alarmuese, të cilët alarmojnë nëse përdoruesi bën përpjekje që ta nxjerrë jashtë objektit materialin në mënyrë jolegale.

Për ta lehtësuar procedurën e huazimit, materialit i vendoset në kopertinë një tiketë me barkod, e cila do ta luajë rolin e identifikuesit të atij materiali (fig.2). Para se t'i jipet përdoruesit materiali, së pari, me anën e një dorëze laserike (dorëza është e ngjashme, si ato që përdoren sot nëpër minimarkete) rrezatohet mbi tiketën e barkodit, ku automatikisht në kompjuter figuron se libri është dhënë në huazim(fig.3).

Po ashtu, kur materiali kthehet nga huazimi, përsëri rrezatohet me dorëzen laserike mbi barkod dhe nëse



ndonjë kërkues tjetër e kërkon, atëherë ai material figuron se gjendet në fondet e bibliotekës. Pra kjo tiketë me barkod do ta luajë një rol kryesor në huazimin e materialeve të bibliotekës. Për t'u kryer me sukses kjo procedurë e huazimit, duhet që edhe kartelat e anëtarësisë së përdoruesve të jenë të pajisura me barkod.

SHËNIME:

1. Manual del CATMARC, Genaralitat de Catalunya.Departament de Cultura,1992.
2. Zhvillimi i bibliotekonomisë(Buletin me përkthime nga materialet e IFLA-s),Tiranë ,1999.
3. Përshkrimi bibliografik i materialeve bibliotekare, përgatitur nga Fafuri Xhaja,Korfuz-Tiranë,2001.
4. UNIMARC Manual-Authorites Format 2001(concise version) në: http://www.ifla.org/ VI/3/p2001/guideright.htm
5. IFLA Universal Bibliografik Contral and Internatonal MARC Core Program(UBCIM) në:http://www.ifla.org/VI/3/p1996-1/ucat.htm
6. http://www.uib.es/cat.htm
7. http://www.bib.uab.es.htm
8. http://www.bib.upv.es/cattalogoi.htm
9. Nga përvoja praktike,gjatë trajnimit,në bibliotekat e Katalonisë.

Raporti korrelativ ndërmjet librit, lexuesit dhe bibliotekës

Hajrullah MUSTAFA

Raporti korrelativ mes librit - lexuesit - stafit të bibliotekës publike, është çështje që kërkon kohë të gjatë dhe një elaborim multidisiplinar, ashtu siç është edhe vetë nocioni „bibliotekim", që në të vërtetë është nocion shumë i gjerë, sepse përfshin grupin e disiplinave shkencore që merren me librin dhe me shfrytëzuesit e saj, përkatësisht historinë e librit dhe shtypit, historinë e organizimit dhe administrimit të bibliotekave, bibliografinë, psikologjinë e përdoruesve, sociologjinë e leximit etj.

Ky raport vazhdimisht duhet të trajtohet në kontekstin e realitetit dhe perspektivës, sepse paraqet indikatorin kryesor në zhvillimin dhe avancimin e bibliotekave si institucione kulturore, arsimore dhe informative, por edhe shërbimet bibliotekare si veprimtari parësore të bibliotekave publike.

Në një periudhë të mëhershme të zhvillimit të bibliotekarisë në Kosovë, kësaj çështjeje aspak nuk i është kushtuar kujdes dhe ekzistojnë fakte se edhe në realitetin e ri politik, ende nuk i kushtohet kujdes i duhur. Absolutisht, pa mohuar rolin që ka libri si instrument i civilizimit njerëzor, bibliotekat furnizoheshin me ekzemplarë enorm të koleksioneve, pa e analizuar sesa është aktual dhe i nevojshëm, dhe sa joshës dhe sa plotëson nevojat e përdoruesve, përkatësisht, të lexuesve të bibliotekës. Ishte kohë kur ishte me rëndësi që drejtuesit e bibliotekave të referojnë me numrin enormë të fondit librar në bibliotekat e tyre, duke uzurpuar hapësirat edhe ashtu të pamjaftueshme të bibliotekave, pa u preokupuar shumë për krijimtari të mirëfilltë kulturore dhe për koleksione që nxisin zhvillimin e mirëfilltë dhe të gjithanshëm të personalitetit të lexuesit të të gjitha grupmoshave.

Në të ardhmen, biblioteka duhet të ketë kujdes që furnizimi të jetë me moton: „shumë më shumë tituj e më pak ekzemplarë".

Ishte e pakuptimtë „bindja" se në biblioteka mund të punojë gjithkush dhe çdokush pa analizuar në detaje se sa i plotëson ai kuadër kualitetet parësore që të punojë në bibliotekë, sa ka njohuri së paku elementare edukative,



metodike e pedagogjike të komunikojë, të nxisë dhe të stimulojë kulturën e të lexuarit te përdoruesit dhe shfrytëzuesit e librit, bile-bile, edhe ai kuadër që ishte profesionalisht më i ngritur në biblioteka më tepër angazhohej në sektorët e tjerë të bibliotekës, si në klasifikim dhe në përpunim, sesa që angazhohej në huazim dhe në punën me shfrytëzuesit e bibliotekës.

Nga të dhënat kuptojmë se ende nëpër bibliotekat e tjera dominon personeli me përgatitje të mesme shkollore. Edhe pas pesë vjetësh të pasluftës, nuk kemi katedër ose fakultet të bibliotekarisë.

Aq më keq, edhe në realitetin e ri, për kuadrin profesional të bibliotekarisë është investuar; për trajnimin dhe aftësimin sa më të mirë të këtij kuadri për shërbime bib-

liotekare dhe për qasje sa më të denjë në teknologjinë e re informative.

Është e vërtetë se shtatë, përkatësisht tetë bibliotekat ndërkomunale të Kosovës të përkrahura nga Ministria e Kulturës, jo vetëm që janë pozicionuar, por edhe janë avancuar dukshëm në zhvillimin dhe afirmimin e lëmisë së bibliotekarisë. Ato kanë ndryshuar dukshëm dhe pozitivisht fizionominë e fondit librar, kanë shtuar numrin e përdoruesve të bibliotekës, janë duke angazhuar personel të ngritur profesionalisht etj. Megjithatë, prapëseprapë, mendoj se qëndrojmë larg realizimit të objektivave, sepse bibliotekat duhet të jenë në gjendje të reflektojnë ndryshimet në shoqëri, p.sh. variacionet në strukturën familjare, punësimin, ndryshimet demografike, diversitetet kulturore dhe mënyrat e komunikimit. Ato duhet të kenë parasysh kulturat tradicionale si dhe teknologjitë e reja, p.sh. të mbështesin metodat gojore të komunikimit dhe vënien në përdorim të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit.

Përgjegjësia e bibliotekës publike në punën me të gjitha grupmoshat është shumë e madhe. Kështu, puna e bibliotekës me fëmijë është një përgjegjësi shumë e veçantë, jo vetëm në të mësuarit e shkrim-leximit dhe propagandimi i librave, por edhe në organizimin e veprimtarive të veçanta për fëmijë, si tregimi i përrallave, por edhe veprimtari të tjera lidhur me shërbimet dhe burimet e bibliotekës. Vetëm kështu fëmijët inkurajohen të përdorin bibliotekën që në moshë të re, duke krijuar mundësi që të mbesin përdorues të bibliotekës gjatë tërë jetës. Këto dhe veprimtari të ngjashme, mund t'i udhëheqë vetëm një personel i ngritur profesionalisht i bibliotekës, i cili ka së paku njohuri elementare pedagogjike, metodike dhe psikologjike. Ose, p.sh. në Kroaci gjatë dhe pasluftës, biblioteka publike e Zagrebit organizon program të leximit hap pas hapi për të ndihmuar zgjidhjen e problemeve psikosociale të fëmijëve dhe adolesheentëve përmes leximit, këndimit dhe vizatimit.

Prandaj, me të drejtë thuhet se personeli i bibliotekës, përveç punonjës bibliotekar duhet të jetë edhe pedagog i mirë.

Para bibliotekave publike dalin detyra dhe përgjegjësi të mëdha, ndërsa për realizimin e tyre duhet që:

- Institucionet shtetërore t'i mbështesin dhe t'i përkrahin shumë më tepër bibliotekat publike;
- Veprimtaria e shërbimeve bibliotekare duhet t'i përcjellë të gjitha rrjedhat dhe ndryshimet në shoqëri;
- Komunikimi ndërmjet personelit të bibliotekës dhe përdoruesve duhet të jetë shumë produktiv dhe në nivel të merituar, bile duhet aplikuar teknika dhe metoda të reja sociometrike, p.sh: intervistat dhe anketat anonime me anëtarët e bibliotekës, me qëllim që të japë ide dhe propozime se si duhet të jenë shërbimet më bashkëkohore të bibliotekave publike;
- Nëse dëshirojmë ta nxisim kulturën e të lexuarit dhe ta mbajmë një baraspeshë me përdoruesit, bibliotekat publike duhet të kenë një buxhet financiar të mjaftueshëm për begatimin e fondit librar;
- Duhet që bibliotekat publike të kenë një bashkëpunim shumë të madh dhe reciprok me të gjitha entet dhe institucionet publike. Posaçërisht, me ato arsimore, edukative dhe kulturore, në mënyrë që të bëhet afirmimi dhe avancimi i formave të organizimeve kulturore;
- Në nivel institucional të ketë shumë më tepër rigorozitet në veprimtarinë botuese, pra të mos botohet gjithçka, por të përkrahet veprimtaria e mirëfilltë krijuese e kulturore;
- Të ketë bashkëpunim reciprok ndërmjet shtëpive botuese dhe bibliotekave në lidhje me pasurimin e bibliotekave me koleksione të reja, të cilat i përmbushin nevojat dhe shijet e përdoruesve të bibliotekave.

Si përfundim, mund të thuhet se po që se respektohen vlerat dhe standardet që u cekën më lart, bibliotekat publike mund të jenë të avancuara dhe mund të kryejnë funksionin e duhur kulturor, edukativ dhe informativ.

Gjendja e fondeve muzikore në BKUK

Edona MUNISHI

Në kuadër të Departamentit për Koleksione të Veçanta të BKUK-së është përfshirë edhe fusha e muzikës me tërësinë e saj të shfaqur si e shkruar, e incizuar dhe si krijimtari e formave të tjera. Kjo pjesë e pasurisë mendore e këtij Departamenti kërkon një përkushtim më të madh dhe një punë shumë më të organizuar për ta bërë më të pasur dhe më të përdorshme. Në rrethanat e krijuara të organizimit të punëve në këtë institucion shtrohet domosdo edhe konstatimi i gjendjes së deritashme të materialeve e fondeve muzikore.

Rrethanat e krijuara gjatë kohës së luftës në Kosovë, kishin shkaktuar një kaos të vërtetë në organizimin dhe gjendjen e pasurisë biliotekare në tërësi. Koha e ardhjes sime përputhej me një angazhim shumë serioz rreth kthimit të Bibliotkekës në një gjendje normale të funksionimit të saj. Në këtë kontekst ndodhi edhe me fondet muzikore që ishin këtu. Me padurim prisja që të fillonim punën në evidencimin e gjendjes së fondeve -materialeve muzikore. Me vendimin e organeve udhëheqëse të Bibliotekës, u organizua, në mënyrë urgjente, regjistrimi i të gjitha fondeve të Bibliotekës, pra edhe të atyre të muzikës. Kjo ishte mundësia dhe rruga më normale për të mësuar se çka posedon kjo Bibliotekë nga lëmi i muzikës në tërësi. Që në fillim duhet ta them se ajo që shihja ishte demoralizuese me gjendjen e materialeve muzikore. Vetë vendi ku ato ndodheshin ishte tmerreus. I tërë materiali fonik ishte i lënë pas dore në bodrume të Bibliotekës, i hedhur në grumbuj, pa të dhëna (pa kartela të evidencës) pa shënime dhe totalisht i paorganizuar e i pasistemuar. Është dashur kohë dhe mund fizik që ai material të bartet në një hapësirë tjetër ku do të bëhej regjistrimi i tij. Me ngritjen e një komisioni të veçantë, në të cilin isha përfshirë edhe unë, filloi puna në regjistrimin e tërë materialit muzikor që gjendej në hapësirat e Bibliotekës. Ky komision, me një qasje shumë serioze, arriti që brenda dy-tre muajve ta kryejë punën e vet me të cilën ishte angazhuar. Rezultatet e punës së këtij komisioni u paraqitën përmes një raporti pune që iu prezantua organeve të Bibliotekës. Ky komison pati për detyrë që ta bëjë vetëm evidencimin e llojeve të materialeve që ndodheshin në Bibliotekë, po jo edhe sistemimin e tij sipas zhanreve muzikore. Në këtë kontekst, komisioni konstatoi vetëm sasinë e llojeve të materialeve. E shohim me interes për kohën që ta lëmë të shënuar në formë shkrimore gjendjen aktuale të pasurisë muzikore që gjendet në këtë institucion.

LLOJET E MATERIALEVE

Materiali i pranishëm në këtë Bibliotekë ishte kryesisht i karakterit fonik, pak i përfaqësuar në literaturë krijuese (partitura) mjaft pak edhe me literaturë të shkruar muzikore-libra të muzikës. Me këtë renditje edhe mund ta shohim fondin e tërësishëm muzikor.

Në BKUK ishte grumbulluar një numër i disqeve klasike të formatit të vogël dhe të madh, audio-kaseta, videokaseta, po edhe incizime në CD. Sipas regjistrimit të komisionit është konstatuar kjo sasi e llojeve të muzikaleve - materialeve:

Pllaka (dhe audio kaseta) të mëdha	=5758
Pllaka (disqe) të mesme	= 41
Pllaka (disqe) të vogla	=6093
Gjithsej:	=11892

Një numër relativisht i madh i disqeve dhe i kasetave ishin me kopertina të zbrazëta: 1154

Shikuar nga kriteri i sasisë, ky numër nuk është as shumë e as pak, por është e qartë se i tërë materaili i mbledhur është bërë pa ndonjë kriter profesional dhe është lënë totalisht i pa sistemuar sipas karakterit profesional të tij. Mungesa e inventarizimit, mungesa e të dhënave të shënuara për materiale, e pamundëson paraqitjen objektive me përqindje të sakta të sasisë së materialeve sipas llojeve, ose sipas përkatësisë gjuhësore. Prandaj, jemi të detyruar që këto prezantime t`i paraqesim aproksimativisht të përshkruara me fjalë. Sasia më e madhe e materialeve muzikore është grumbulluar në periudhën deri në vitet e nënëdhjeta, kjo mund të shihet nga llojet dhe karakteri i tyre. Mirëpo, meqë pas viteve të nëntëdhjeta kjo Bibliotekë ishte në mbikëqyrje të organeve të vendosura nga regjimi politik i Serbisë, edhe politika e grumbullimit dhe e sigurimit të fondeve muzikore ishte ortientuar mbi baza të ngarkesave nacionale që më së miri argumentohet përmes përfaqësimit gjuhësor të materialeve muzikore. Nga e tërë sasia e disqeve, pjesa shumë më e madhe ishin në gjuhën serbe, një numër më i vogël në gjuhët e huaja, dhe

fare, fare pak në gjuhën shqipe. Po kështu mund të thuhet edhe për audio kaseta, ku nga numri i përgjithshëm shumica ishin në gjuhën serbe, me ndonjë përfaqësim simbolik në gjuhët e huaja dhe në gjuhën shqipe.

Nuk do të ishte shumë tragjike, edhe pse e padrejtë, sikur i tërë ky material të ishte grumbulluar me kritere profesionale dhe me kujdes në cilësinë krijuese e artistike të pranisë së tij në një institucion siç është Biblioteka Kombëtare Universitare. Mirëpo, i punësuari në përzgjedhjen e këtij materiali jo vetëm që ka qenë i ngarkuar me nacionalizëm po edhe shumë modest në njohuritë e tij profesionale muzikore. Ky konstatim del shumë i qartë vetëm në shikimin e zhanreve muzikore të pranishme. Në këtë plan numri më i madh i incizimeve fonike janë të përfaqësuara me të ashtuquajtura muzikë të re popullore të kompozuar ("Novokomponovana narodna muzka") dhe me nivelet më të ulta të vlerave të tyre, që i takojnë kuazivlerave të mbushura me kategoritë e shundit, kiçit, dukuri të shfaqura në të gjitha mjediset kulturore ballkanike në këto dekadat e fundit pra edhe në mjedisin kulturor të Serbisë, prej nga janë marrë materialet e këtij karakteri. Nga i tërë ky material, më së shumti ka kaseta të këngëtarëve që edhe në mjediset e tyre kulturore janë sulmuar nga kritika muzikore për deformime të shumta karakteresh të ndryshme të këtij zhanri muzikor, siç është, bie fjala: Ceca, Dragna Mirkoviç, e shumë e shumë të tjerë. Ka një sasi disqesh të mëdha ose të vogël me muzikë të lehtë (argëtuese) ku janë kryesisht këngëtarë të viteve të shtatëdhjeta e më pas të kësaj muzike të mjediseve të ndryshme të Jugosllavisë së Titos. Kështu, me muzikë të lehtë në pllaka gramafoni gjenden këngëtarët, si: Gjorgje Marjanoviçi, Oliveri, Oto Pesner, Kemal Monteno, Snezhana Saviç, Darko Domijan, Jasna Zlokiç etj., pastaj me grupe të njohura të rock muzikës së atyre viteve etj. Edhe në këtë zhanër këngësh asnjë pllakë nuk është me këngëtarë shqiptarë. Në incizime fonike në pllaka gramafoni është një numër shumë simbolik me muzikë serioze dhe atë me vepra të kompozitorëve serbë si: Stanojllo Raiçiç, Milutin Radenkoviç, Dragutin Gosturshki etj., pra pa asnjë vepër të kompozitorëve shqiptarë apo të kompozitorëve botërorë stilesh e epokash të ndryshme.

Literatura në fushë të krijimtarisë muzikore është e varfër, qoftë në planin sasior, por edhe cilësor. Edhe në këtë lloj fondesh muzikore vërehen dy periudha të sigurimit të veprave muzikore në partiturë – të kohës para luftës në Kosovë (1999) dhe të pas luftës – pra të viteve të fundit. Së pari është i konstatueshëm fakti se kjo Bibliotekë disponon me numër të vogël të veprave muzikore formash e gjinish të ndryshme të kompozitorëve, të shënuara në partiturë - qoftë të botuara ose në dorëshkrime. Edhe ajo sasi e veprave që ekziston, nuk është representative; nuk është proporcionalisht kënaqshëm e prezantuar nga mjediset kulturore qoftë botërore po edhe ballkanike. Me rreth 70 vepra në partitura, aq sa ka arritur komisioni t'i konstatojë, nuk mund të jetë ndonjë lavd i madh për prani të literaturës së krijimtarisë muzkore. Veprat e koleksionuara janë grumbulluar pa ndonjë kriter profesional dhe pa ndonjë kujdes për mjedisin tonë kulturor. Gjenden këtu veprat e disa kompozitorëve sllovenë, kroatë, serbë, emrat e të cilëve nuk çojnë peshë të madhe në krijimtarinë muzikore të mjediseve të tyre, gjendet aty këtu ndonjë vepër për violinë, vilonçelo të kompozitorëve gjermanë, dy tri vepra të J.S. Bachut, etj. Nga krijimtaria muzikore shqiptare, ka një numër veprash të siguruara viteve të fundit të autorëve, si: Rauf Dhomi (6 vepra), Prenk Jakova (me dy operat e tij), me nga ndonjë vepër të Zeqiria Ballatës, Feim Ibrahimit, Çesk Zadesë, Pjetër Gacit, Nikolla Zopraqit, Vinçenc Gjinit, Shime Deshpalit (këngë korale) Esat Rizvanollit etj., me krijimtari për fëmijë: Lorenc Antoni, Severin Kajtazi, dhe këto janë fare pak. Tekste, përkatësisht libra në fushën e muzikës, gjithashtu, nuk paraqesin ndonjë pasuri për lakmi dhe ngjashëm me materialet e tjera qëndron gjendja edhe në këtë fushë. Librat e siguruara deri në vitin 1999 janë kryesisht të karakterit pedagogjik, të shkruara në një kohë që tashmë, si dije, është tejkaluar. Këtu ka dy-tri tekste muzike për shkollë fillore në gjuhën shqipe të autorit Ismajl Hoxha, disa libra të përkthyer në gjuhën serbe të autorëve si bie fjala Derik Kuk, Gjuha e muzikës (Jezik Muzike), Donald Miqell, Gjuha e muzikës moderne (Jezik moderne muzike), ndonjë enciklopedi e muzikës në gjuhën serbokroate, e tekste shkollore në gjuhë sllovene, serbe, maqedone, etj. Nga autorët shqiptarë, janë disa libra të fushave më shumë shkencore të muzikës, të dhuruara viteve të fundit, si të: Skënder Selimit, Ramazan Bogdanit, Rexhep Munishit, që është numër shumë simbolik i pranisë së botimeve muzikore.

Materialet e koleksionuara në këtë institucion nuk kanë shumë të përbashkët me emërtimin - Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës. Në të ka fare pak materiale të muzikës, të karakterit kombëtar, mjaft pak të atij universitar, po edhe shumë pak materiale nga mjediset kulturore botërore natyrisht edhe nga vetë mjedisi ynë kulturor. Tani, kur t`i shtohet fakti se edhe ky material që aktualisht gjendet në Bibliotekë është i pasistemuar, i paevidentuar, pa bibliografi muzikore, pa katalogë, atëherë shihet qartë një gjendje jo e favorshme për t'i ofruar dhe plotësuar kërkesat e përdoruesve në fushë të muzikës, përkatësisht të kulturës muzikore, në çfarëdo forme qoftë. Prandaj, me çfarëdo kriteri që ta shikojmë gjendjen e koleksionit në fushë muzikologjisë në Bibliotekë, nuk mund të flitet për ndonjë pasuri fondesh muzkore. Mirëpo, iniciativa për ta aktivizuar edhe pjesën që i takon muzikës jep shpresë për një konsolidim të favorshëm të këtij sektori të rëndësishëm të bibliotekarisë.

U themelua Konsorciumi i Bibliotekave Elektronike të Kosovës

Pas një sërë të rejash në fushën e bibliotekarisë, në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare u themelua edhe Konsorciumi i Bibliotekave Elektronike të Kosovës, inaugurimi i të cilit u bë më 22 prill - gjatë Javës së Bibliotekës në Kosovë. Konsorciumi është një bashkësi bibliotekash që synon të mbledhë rreth vetes të gjitha bibliotekat dhe institucionet informative të Kosovës, e më vonë të shtrihet edhe më gjerë në rajon, për të ofruar shërbime të përbashkëta - sa më cilësore, për përdoruesit. Konsorciumi i Bibliotekave Elektronike të Kosovës është pjesë e një konsorciumi më të madh me shtrirje botërore - atë të eIFL.net, e cila u shërben mëse 2200 bibliotekave në 40 vende të botës. Konsorciumi i Bibliotekave Elektronike të Kosovës u realizua duke iu falënderuar Institutit për Shoqëri të Hapur, pjesë e rrjetit të Fondacionit Soros, i cili i dha BKUK-së një grant prej 8.934 ¤ për të mundësuar promovimin e burimeve elektronike në këtë rajon të Evropës Juglindore. Nevoja për një projekt të tillë lindi si reagim ndaj shfrytëzimit shumë të ulët të burimeve elektronike në Kosovë, të cilat, pa dyshim, paraqesin burime të pazëvendësueshme intelektuale. Porse në këtë kontekst, shfrytëzimin e burimeve elektronike e vështirëson infrastruktura e dobët e bibliotekave të Kosovës. Megjithatë, edhe me të vështirë, shfrytëzimin e burimeve elektronike, e bën fakti se vetëdija ekzistuese është tepër e ulët përkatazi me vlerën e burimeve elektronike në të gjitha nivelet arsimore të Kosovës. Duke e ditur rolin e bibliotekave në këtë drejtim dhe duke ditur se biblioteka është qendër e përhapjes së dijes dhe informacionit, konsorciumi do të organizojë një varg aktivitetesh në bibliotekat kryesore të Kosovës, si dhe në të tjera të karakterit promovues të burimeve elektronike, për të shpalosur vlerën e tyre të vërtetë para: bibliotekarëve, përdoruesve, po ashtu edhe para mësuesve e profesorëve, të cilët mund t'i shfrytëzojnë këto burime në punën e tyre me nxënës dhe studentë. Bibliotekat e Kosovës tashmë katër vjet kanë qasje në burimet e EBSCO-s dhe ProQuest-it; për fat të keq statistikat tregojnë për një shfrytëzimin të ulët të tyre.

Duke e parë gjendjen ekzistuese të shfrytëzimit të burimeve elektronike, Konsorciumi i ka vënë objektiva, si:

- të rrisë shfrytëzimin e burimeve elektronike të informacionit;
- të krijojë një rrjet të fuqishëm të bibliotekave dhe institucioneve informative;
- të sigurojë qasje të barabartë në burimet elektronike;
- të integrojë rrjetin e bibliotekave të Kosovës me bibliotekat e tjera elektronike të botës;
- të rrisë shkëmbimin e dijes dhe informacioneve;
- të jetë udhëheqëse e fuqishme për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta;
- të zvogëlojë koston e informacioneve;
- të menaxhojë, përzgjedhë, analizojë dhe identifikojë burimet elektronike për nevojat e vendit;
- të ngrisë vetëdijën për vlerën e burimeve elektronike te bibliotekarët, menaxherët e bibliotekave, zyrtarët e qeverisë dhe te përdoruesit e bibliotekave.

Konsorciumi nuk do të mund të ekzistojë pa zgjerimin e rrjetit, pa bashkëpunimin e bibliotekarëve, pa shkëmbimin ndërbibliotekar të dijes, dhe pa një frymë të mirë bashkëpunimi në të gjitha rrjedhat e fushës së bibliotekarisë. Si rrjedhojë, çdo kush që ka njohuri të caktuara mund të kontribuojë në mënyrën e vet në zhvillimin e sistemit bibliotekar në Kosovë. Kjo paraqet në një farë mënyre edhe shtrirjen që kërkon Konsorciumi. Sistemi bibliotekar në Kosovë është larg standardeve bashkëkohore - bibliotekave të shekullit 21, por kjo nuk do të thotë se nuk është në rrugën e vërtetë të përparimit. Për ta bërë këtë rrugë të qëndrueshme, kërkohet bashkëpunim i ngushtë. Kështu që, krahas promovimit të burimeve elektronike, Konsorciumi do të përqëndrohet edhe në forcimin e bashkëpunimit ndërbibliotekar, dhe se vetëm mbi themele të tilla të shëndosha mund të ekzistojë një konsorcium i mirëfilltë dhe të zhvillohet një sistemi i gjithëmbarshëm bibliotekar pothuaj në një shkallë të barabartë. Sistemet e fuqishme bibliotekare, në të gjitha vendet e botës, janë gjeneratorë të prodhimit të dijes, një gjë të tillë duhet ta kenë në mendje edhe bibliotekat e Kosovës.
Granti do të shërbejë edhe si faktor sensibilizues për bibliotekat e Kosovës se burimet e të ardhurave mund të gjenden edhe tek organizatat e ndryshme brenda e jashtë vendit. Prandaj, bibliotekat me ngulm duhet të orientohen për të fituar burime të ndryshme të financimit. Një prej këtyre hapave të mirë është edhe krijimi i shoqatës Miqtë e BKUK-së, e cila do ta ndihmojë këtë institucion në mbledhjen e fondeve për ndonjë projekt të rëndësisë së veçantë. Kjo ndërlidhje u bë meqë të gjthë këta mekanizma të BKUK-së kanë të vetmin qëllim: përmirësimin e shërbimeve ndaj përdoruesit në të gjitha aspektet bibliotekare. Ndryshimet pozitive për të cilat të gjithë ne synojmë do të jenë të pashmangshme, nëse synohet të bëhet një hap para në zhvillimin e bibliotekarisë bashkëkohore.

Besim J. KOKOLLARI, anëtar i Bordit të Konsorciumit nga Biblioteka e Këndit Amerikan